

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale
për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA**FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË GJENDJEN E FONDEVE	7
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	8
SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE	9

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar menaxhmentit të Iniciativës Kosovare për Stabilitet - IKS

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Iniciativës Kosovare për Stabilitet - IKS, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të IKS-it me 31 dhjetor 2025 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin financiar që ka përfunduar në atë datë në përputhje me Ligjet aktuale në fuqi.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA) dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimin e parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Organizatën, ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përqejësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë.

Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet tjera dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rrezeqe. Ne marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se i atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Përfitojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditim me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Organizatës.
- E vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushtet që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisje lidhur me qasjen e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Armend Osaj – Auditor Ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
30 mars, 2026



Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS
Pasqyra e pozicionit financiar
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

PASURITË	Shënime	2025	2024
		(në EUR)	(në EUR)
Pasuritë afatshkurta			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	6,449	25,332
Llogaritë e arkëtueshme	4	-	-
Totali i pasurive afatshkurta		<u>6,449</u>	<u>25,332</u>
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet		-	-
Totali i pasurive afatgjata		<u>-</u>	<u>-</u>
TOTALI I PASURIVE		<u><u>6,449</u></u>	<u><u>25,332</u></u>
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme tregtare	5	-	1,700
Detyrimet tjera		-	-
Të hyrat e shtyera	6	6,015	23,199
Totali i detyrimeve afatshkurta		<u>6,015</u>	<u>24,899</u>
Ekuiteti			
Fitimi/ (humbja) e bartur		434	3,096
Bilanci fillestar		-	-
Net (deficiti)/surplusi për vitin		-	(2,662)
Totali Ekuitetit		<u>434</u>	<u>434</u>
TOTALI I DETYRIMEVE DHE I EKUITETIT		<u><u>6,449</u></u>	<u><u>25,333</u></u>

Pasqyrat financiare të përgaditura dhe aprovuara janë nënshkruar më 30 mars 2026 nga:

Brikenë Hoxha Jajaga

Drejtoreshë Ekzekutive

Florina Baruti

Menaxhere e Financave

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 15 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Shënime	Për fundin e vitit me 31 Dhjetor 2025 (në EUR)	Për fundin e vitit me 31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Të hyrat			
Të hyrat nga Grantet	7	155,405	160,982
Të hyrat tjera		-	-
Totali i të hyrave		155,405	160,982
Shpenzimet			
Pagat dhe benefitet	8	93,772	89,130
Qeraja		9,231	9,231
Shpenzimet për komunal		1,492	908
Telephone and Internet	9	1,203	1,292
Furnizimet për zyre		516	775
Shpenzimet e udhëtimit	10	4,880	1,067
IT dhe mirëmbajtja e web-it		562	545
Shërbimi i Auditimit		-	1,700
Printimi dhe visibiliteti	11	15,672	3,760
Shërbimet e kontraktuara	12	1,484	10,600
Provisionet bankare		424	277
Kostot sipas programeve		19,310	18,812
Kostot sipas programeve - Granteve		5,689	24,828
Të tjera		1,170	720
Totali i shpenzimeve		155,405	163,645
Net (Deficiti)/surplusi për vitin		-	(2,662)

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 15 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS
Pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

Pasqyra e Tepricave/Mungesave	Teprica/Mungesa e akumuluar	Gjithsejt
Më 1 Janar 2024	-	-
Teprica (mungesa) për vitin	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	<u>-</u>	<u>-</u>
Më 1 Janar 2025	-	-
Teprica (mungesa) për vitin	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2025	<u>-</u>	<u>-</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 15 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Për fundin e vitit me 31 Dhjetor 2025 (në EUR)	Për fundin e vitit me 31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
Fitimi/Humbja neto	-	(2,662)
Rregulluar për:		
Zhvlerësimin	-	-
Ndryshimet në të arkëtueshmet nga shteti	-	-
Ndryshimet në të pagueshme	(1,700)	-
Ndryshimet në të hurat e shtyera	(17,184)	16,618
Ndryshimet obligimet tjera	-	-
Paratë e gjeneruara nga operacionet	(18,883)	13,955
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese	(18,883)	13,955
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	25,332	11,377
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fund të periudhës	6,449	25,332

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 15 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

1. INFORMATAT GJENERALE

Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS është një organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse që përqendrohet në kërkimin empirik dhe analizën e zhvillimeve socio-ekonomike në Kosovë. E financuar në vitin 2004, IKS ofron kërkime inovative dhe relevante për politikën me qëllim fillimin e debateve mbi çështje me rëndësi për të ardhmen e Kosovës.

Misioni i Iniciativës Kosovare për Stabilitet – IKS është të çojë më tej mirëqenien e qytetarëve të Kosovës përmes hulumtimeve empirike, inicimit të politikave publike të informuara mirë, rritjes së ndërgjegjësimit, bashkëpunimit rajonal, avokimit dhe rrjetëzimit.

Ne besojmë se debatet publike të bazuara në prova qëndrojnë në thelb të vendimmarrjes demokratike. Që nga fillimi i saj, puna e IKS është përqendruar në çështjet e qeverisjes, zhvillimit ekonomik, planifikimit urban, papunësisë dhe të rinjve, reformës së administratës publike, dialogut social, antikorrupsionit në rindërtimin e pasluftës, problemit të imazhit të Kosovës, arsimit, çështjeve mjedisore dhe trashëgimisë kulturore.

All reports are freely available on our website www.iksweb.org

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare për Organizatën janë përgatitur në bazë të parave të gatshme për të ardhurat dhe shpenzimet. Bazat e matjes përshkruhen më hollësisht në politikat kontabël të përcaktuara më poshtë.

2.2 Valuta e prezantimit

Monedha funksionale e Organizatës është njësia monetare e Bashkimit Evropian Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare të biznesit paraqiten në Euro.

2.3 Cash and cash equivalents

Për qëllimet e pasqyrës së fluksit të parave të gatshme, paratë e gatshme dhe ekuivalentët e tyre konsiderohen si para të gatshme në dorë dhe në bankë dhe në llogaritë operative në bankë me një maturim fillestar prej tre muajsh ose më pak..

2.4 Të pagueshmet tregtare

Shumat e pagueshme maten me kosto, e cila është vlera e drejtë e shpërblimit që do të paguhet në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e marra, pavarësisht nëse i faturohen biznesit apo jo.

2.5 Tatimet

Organizata u krijua si një organizatë joqeveritare prandaj, ajo ka përgjegjësi dhe vepron si OJQ sipas ligjeve në fuqi të Kosovës.

2.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga grantet njihen si të ardhura në periudhën në të cilën paguhen. Në fund të vitit, shuma e tepërt e të ardhurave përveç shpenzimeve trajtohet si një bilanc i mbartur në periudhën tjetër.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2.7 Kostot financiare

Kostot financiare përfshijnë tarifatat bankare të ngarkuara për transaksionet bankare dhe koston e ngarkuar për garancinë e marrë, si dhe shpenzimet e interesit për huatë.

2.8 Benefitet e punëtorve

Organizata, në rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa në Trustin Pensional në emër të punonjësve të saj. Shumica e punonjësve të Organizatës janë anëtarë të planit shtetëror të pensioneve që kryhet nëpër mjet Trustit Pensional. Të gjitha kontributet e tilla në skemat e detyrueshme qeveritare të pensioneve njihen si shpenzime kur ato ndodhin. Organizata nuk operon me ndonjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas daljes në pension dhe, si pasojë, nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pensionet.

Përveç kësaj, Organizata nuk ka detyrime materiale për të ofruar përfitime të mëtejshme për punonjësit aktualë dhe të mëparshëm.

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

3. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)	31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Paraja në arkë	207	169
Paraja në bankë	6,242	25,163
Totali i parasë së gatshme	6,449	25,332

4. LLOGARITË E ARKËTUESHME

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)	31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Llogaritë e arkëtueshme	-	-
Totali i llogarive të arkëtueshme	-	-

5. LLOGARITË E PAGUESHME DHE AKRUALET

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)	31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Llogaritë e pagueshme	-	1,700
Akrualet	-	-
Totali i llogarive të pagueshme	-	1,700

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

6. TË HYRAT E SHTYERA

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)	31 Dhjetor 2024 (në EUR)
CDF	1,700	-
Komisioni European - Ryde	212	9,720
GIZ	-	6,635
MKRS	5,500	-
EU-KGSC	(1,721)	6,844
Të tjera	325	-
Të hyrat e shtyera	6,015	23,199

7. TË HYRAT

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)	31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Komisioni European - RYDE	32,448	13,181
CDF	80,709	71,005
OPC	-	15,785
GIZ	8,622	11,365
EU-KGSC	29,624	49,646
MKRS	3,900	-
Të tjera	102	-
Totali i të hyrave nga Grantet	155,405	160,982

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

8. SHPENZIMET E PAGAVE DHE BENEFITEVE

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)	31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Pagat bruto	90,420	85,964
Kontributet Pensionale	3,352	3,166
Totali i pagave dhe i benefiteve	93,772	89,130

9. SHPENZIMET PËR TELEFON DHE INTERNET

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)	31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Shpenzimet për telefon	737	826
Shpenzimet për internet	465	465
Totali i shpenzimeve për telefon dhe internet	1,203	1,292

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

10. SHPENZIMET E UDHËTIMIT

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)	31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Shpenzimet e udhëtimit	4,880	1,067
Shpenzimet për veturë	-	-
Totali i shpenzimeve të udhëtimit	4,880	1,067

11. PRINTIMI DHE VEPRIMET RRETH VISIBILITETIT

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)	31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Debatet	1,750	-
Kampanjat për rrijjen e ndërgjegjësimit	8,792	-
Material promocional	-	-
Prodhimi i filmit dokumentar	2,500	2,000
Shpenzimet rreth mbledhjes së informatave	-	-
Printimi dhe veprimet e vizibilitetit	2,630	1,760
Total printimi dhe veprimet rreth vizibilitetit	15,672	3,760

12. SHËRBIMET E KONTRAKTUARA

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)	31 Dhjetor 2024 (në EUR)
Shërbimet e kontraktuara	1,484	10,600
Totali i shërbimeve të kontraktuara	1,484	10,600

Iniciativa Kosovare për Stabilitet - IKS

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

15. PALËT E NDËRLIDHURA

Për qëllimet e këtyre pasqyrave financiare, palët konsiderohen të lidhura nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operationale, siç përcaktohet nga SNK 24 "Zbulimet e Palëve të Lidhura". Gjatë shqyrtimit të çdo marrëdhënieje të mundshme me palë të lidhura, vëmendja i drejtohet substancës së marrëdhënies, jo thjesht formës ligjore.

14. MENAXHIMI I RISKUT

14.1. Risku Kreditor

Instrumentet financiare, të cilat potencialisht e ekspozojnë IKS-in ndaj përqendrimeve të rrezikut të kreditor, përbëhen kryesisht nga të arkëtueshmet tregtare dhe mbajtjet e parave të gatshme në bankë. Rreziku i kreditor i Organizatës menaxhohet duke vendosur paratë e saj dhe ekuivalentët e tyre në institucione financiare me cilësi të lartë. Rreziku kreditor i të arkëtueshmeve kontrollohet përmes kushteve të rishikuara të kreditit (maksimumi 15 ditë si limit krediti), miratimeve të kreditit, limiteve të kreditit dhe procedurave të monitorimit.

14.2. Risku i Interesit

Organizata nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit pasi nuk ka huazime ose vendosje në depozita.

14.3. Risku Këmbimit Monetar

Organizata paguan detyrimet në valutë të huaj brenda një periudhe të shkurtër kohore, duke zvogëluar kështu rrezikun që ndryshimet në valutë të huaj do të rezultojnë në humbje të konsiderueshme.

14.4. Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit lind në financimin e përgjithshëm të aktiviteteve të Organizatës dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ai përfshin si rrezikun e pamundësisë për të financuar asetet me maturim dhe norma të përshtatshme, ashtu edhe rrezikun e pamundësisë për të likuiduar një aset me një çmim të arsyeshëm dhe në një afat kohor të përshtatshëm për të përmbushur detyrimet e detyrimeve.

Organizata monitoron likuiditetin e saj në mënyrë periodike në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur ato bëhen të skadueshme. Që nga 31 dhjetori 2025, asetet dhe detyrimet financiare të Organizatës kanë maturim më pak se 12 muaj.

15. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpallje në pasqyrat financiare.